



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë , më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “RRETHIMI I VARREZAVE LEKAJ, TËRBAÇ”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45215400-1 -
Punime ndërtimi për varreza,**

VLERA E FONDIT: 1 666 666,66 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa TVSH**

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- *NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë;*
- *NP-2A – Ndërtime civile dhe industriale.*

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- *NS-18 A – Punime topogjeodezike.*

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, merr përsipër të realizojë.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë, referuar VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.

Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 39, pika 6, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore*”, Ligjin Nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 të ndryshuar, VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Në bazë të liçencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit “A” që i përgjigjet kësaj vlere.

Bazuar në natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv, licencat e kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin dhe volumet e punimeve që do të realizohen.

Kriteri është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, tipologjinë dhe kompleksitetin teknik të punimeve të parashikuara në preventivin e objektit “Rrethimi i varrezave Lekaj, Tërbaç”.

Nga analiza e preventivit rezulton se objekti përfshin disa kategori punimesh ndërtimore, të cilat kërkojnë kapacitete dhe kompetenca profesionale përkatëse për realizimin e tyre në përputhje me kërkesat teknike të projektit dhe rregullat e zbatimit të punimeve.

Në mënyrë konkrete, preventivi përfshin:

- Punime gjurmimi, ku parashikohet gjurmim dheu me ekskavator në kanale me gjerësi deri në 2 m, në tokë të zakonshme, Kategoria IV, me ngarkim dhe transport në mjet. Këto punime lidhen drejtpërdrejt me kategorinë NP-1 – Punime gjurmimi në tokë.
- Punime dheu, të cilat përfshijnë hedhje, rrafshim dhe mbushje dheu, si dhe punime të tjera të lidhura me përgatitjen dhe sistemimin e terrenit. Këto punime janë pjesë integrale e procesit të zbatimit të veprës ndërtimore.
- Punime hekuri dhe betoni, ku preventivi parashikon hekur për struktura, shufra hekuri dhe shtrimin e betonit.
- Punime betoni dhe betonarmeje, ku parashikohet realizimi i strukturave monolite prej betoni C16/20. Këto punime përbëjnë elemente konstruktive të objektit dhe kërkojnë kapacitet profesional për realizimin e punimeve të ndërtimit.
- Punime konstruksionesh metalike, ku preventivi parashikon edhe realizimin e konstruksioneve metalike të thjeshta.

Në këtë kuadër, kërkesa për kategorinë NP-2A – Ndërtime civile dhe industriale justifikohet nga fakti se objekti nuk kufizohet vetëm në punime të thjeshta gjurmimi apo sistemimi terreni, por përfshin punime ndërtimore me karakter konstruktiv, konkretisht punime hekuri, betoni, betonarmeje dhe konstruksione metalike, të cilat janë pjesë përbërëse e realizimit të objektit.

Sa i përket kategorisë NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë, kjo kategori është e lidhur drejtpërdrejt me zërin e preventivit për gjurmimet me mjete mekanike në kanale. Për rrjedhojë, kërkesa për këtë kategori synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin profesional të nevojshëm për realizimin e punimeve të gjurmimit sipas kërkesave teknike të projektit.

Për kategorinë NS-18 A – Punime topogjeodezike, kërkesa lidhet me nevojën për realizimin e veprimeve topografike dhe gjeodezike që shoqërojnë procesin e zbatimit të punimeve ndërtimore, veçanërisht për përcaktimin në terren të pozicionit, kuotave, akseve dhe elementeve të objektit, si dhe për kontrollin e realizimit të tyre në përputhje me projektin.

Kërkesa për këto kategori licence është rrjedhimisht e lidhur me objektin konkret të kontratës dhe me natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv, duke synuar që operatori ekonomik që do të realizojë punimet të ketë kapacitetin profesional të nevojshëm për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, kërkesa që, në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar të paraqesë licencat profesionale përkatëse sipas zërave të preventivit që merr përsipër të realizojë, lidhet me nevojën për të garantuar që çdo pjesë e punimeve që i ngarkohet një anëtar të bashkimit të realizohet nga një subjekt që disponon kapacitetin dhe licencimin profesional përkatës. Kjo qasje bën të mundur lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet përgjegjësisë për realizimin e zërave të preventivit dhe kompetencës profesionale të subjektit që merr përsipër këto punime.

Për operatorët ekonomikë të huaj, parashikimi për ekuivalentimin e licencave profesionale pranë institucionit kompetent në Republikën e Shqipërisë synon të sigurojë njohjen dhe vlefshmërinë e dokumentacionit profesional të tyre për ushtrimin e aktivitetit përkatës në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kuadrin rregullator të referuar në kriter.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”; nenin 43 pika 2/c dhe pika 3, nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohen se:

“2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme”.

“3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në

këtë lloj procedurë prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.*

Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.*

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron është vendosur konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 95 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore si dhe me situacionet e punimeve dhe akt-kolaudimin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë

se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përkrahur nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Referuar nenit 55 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, është përcaktuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Përcaktimi i vlerës minimale prej 95% të vlerës limit të kontratës synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë një eksperiencë reale dhe të konsoliduar në realizimin e punimeve të ngjashme, në një volum ekonomik të konsiderueshëm dhe të krahasueshëm me përmasat e kontratës objekt prokurimi. Ky nivel kërkesë është i arsyeshëm duke pasur parasysh se kontrata përfshin një kombinim të punimeve të prishjes, gërmimit, transportit, ndërtimit të shtresave konstruktive, betonimit dhe shtrimit të sipërfaqeve me gur natyral.

Kërkesa është vendosur duke respektuar përcaktimin ligjor sipas të cilit, për kontratat e punëve në procedurat e thjeshtuara, vlera e punëve të ngjashme të kërkuara në total gjatë pesë viteve të fundit nuk duhet të jetë më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Në rastin konkret, kërkesa prej 95% është më e ulët se kufiri maksimal prej 100% të vlerës limit të kontratës dhe, për rrjedhojë, qëndron brenda kufirit të përcaktuar nga kuadri ligjor.

Në përputhje me përcaktimin ligjor, kriteri është konceptuar në mënyrë alternative, duke parashikuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve të përvojës së ngjashme e bën ofertën të kualifikueshme. Për rrjedhojë, operatorët ekonomikë kanë mundësi të dëshmojnë kapacitetin e tyre profesional ose nëpërmjet realizimit të një pune të ngjashme për një objekt të vetëm, brenda kufirit të përcaktuar përkatësisht nga legjislacioni, ose nëpërmjet realizimit të disa punëve të ngjashme, vlera monetare totale e të cilave plotëson prapenjë e kërkuar

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë personelin kryesor drejtues teknik, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe që figuron në listëpagesën e shoqërisë për muajin Korrik 2026, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) Inxhinier Mekanik;
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, kontratë pune, CV dhe librezë pune.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, të renditur i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të vetëdeklaruara, si dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës të paraqitura në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.2, që kërkon disponimin nga operatori ekonomik të personelit kryesor drejtues teknik të përbërë nga 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, 1 (një) Inxhinier Mekanik dhe 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder, është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, llojin dhe kompleksitetin e punimeve që përfshihen në objektin e kontratës, si dhe nevojën për garantimin e zbatimit të tyre në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe kërkesat e sigurisë e të cilësisë.

Objekti i kontratës përfshin punime ndërtimore të natyrave të ndryshme, ndër të cilat punime gërmimi, punime dheu, punime hekuri, betonarmeje, beton dhe konstruksione metalike. Këto

punime kërkojnë organizim, drejtim dhe kontroll teknik nga personel me formim profesional të përshtatshëm për secilën prej fushave kryesore të zbatimit.

Kërkesa për disponimin e një Inxhinieri Ndërtimi lidhet drejtpërdrejt me natyrën kryesore të objektit, i cili është një objekt ndërtimor dhe përfshin punime të lidhura me përgatitjen e terrenit, gërmimet, themelet/elementet prej betoni, betonarmenë, hekurin dhe elemente të tjera konstruktive. Inxhinieri i Ndërtimit është i nevojshëm për drejtimin dhe koordinimin teknik të punimeve të ndërtimit, interpretimin dhe zbatimin e projektit, kontrollin e proceseve të punës, verifikimin e zbatimit të elementeve konstruktive dhe koordinimin ndërmjet zërave të ndryshëm të punimeve. Në preventiv parashikohen, ndër të tjera, punime gërmimi, punime hekuri dhe betonarmeje, përfshirë përdorimin e betonit për elemente të objektit. Për këtë arsye, disponimi i një specialisti me profil ndërtimi është i lidhur drejtpërdrejt me realizimin teknik të punimeve kryesore të kontratës.

Kërkesa për Inxhinier Mekanik është përcaktuar në funksion të proceseve të punës që kërkojnë përdorimin dhe administrimin teknik të mjeteve, makinerive dhe pajisjeve mekanike të angazhuara në zbatimin e kontratës. Në preventiv parashikohen punime gërmimi me mjete mekanike, përfshirë përdorimin e ekskavatorit, si dhe ngarkimin dhe transportin e materialeve me mjete transporti. Në këto kushte, prania e një Inxhinieri Mekanik në personelin drejtues teknik synon të garantojë administrimin dhe koordinimin teknik të pajisjeve dhe mjeteve mekanike të përdorura në kantier, duke përfshirë kontrollin e përshtatshmërisë së tyre për proceset e punës, koordinimin e përdorimit të tyre dhe respektimin e kërkesave teknike dhe të sigurisë gjatë operimit. Kërkesa nuk lidhet vetëm me disponimin formal të një profili profesional, por me nevojën për të pasur në strukturën drejtuese teknike të kontraktorit një specialist që mbulon komponentin mekanik të proceseve të zbatimit ku përdoren makineri dhe pajisje.

Kërkesa për një Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder lidhet me nevojën për kontrollin topografik dhe gjeodezik të zbatimit të punimeve në terren. Për realizimin korrekt të një objekti ndërtimor është e nevojshme që pozicionimi i tij në terren, përcaktimi i akseve, kuotave dhe dimensioneve të elementeve të zbatimit të kryhet dhe kontrollohet nga personel me kompetencë profesionale në fushën e topografisë/gjeodezisë. Kjo nevojë është veçanërisht e rëndësishme në fazat e përgatitjes së terrenit dhe gërmimeve, si dhe gjatë realizimit të elementeve të objektit, me qëllim që zbatimi në terren të jetë në përputhje me projektin dhe parametrat teknikë të përcaktuar. Për rrjedhojë, kërkesa për këtë profil profesional synon të sigurojë kontrollin e saktësisë së punimeve dhe përputhjen e pozicionimit dhe kuotave të objektit me dokumentacionin teknik të kontratës.

Tre profilet profesionale të kërkuara mbulojnë komponentë të ndryshëm, por të ndërlidhur, të procesit të zbatimit:

- Inxhinieri i Ndërtimit mbulon drejtimin dhe kontrollin e punimeve ndërtimore dhe konstruktive;
- Inxhinieri Mekanik mbulon komponentin teknik që lidhet me makineritë, pajisjet dhe mjetet mekanike të përdorura gjatë zbatimit;
- Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder mbulon kontrollin topografik dhe gjeodezik të pozicionimit, akseve dhe kuotave të punimeve.

Kombinimi i këtyre profileve krijon një strukturë minimale drejtuese teknike të përshtatshme për mbulimin e proceseve kryesore të punimeve të parashikuara në preventiv dhe për koordinimin e tyre gjatë zbatimit.

Kërkesa për personel të tillë synon të garantojë që punimet të mos realizohen vetëm nëpërmjet kapaciteteve materiale të operatorit ekonomik, por të jenë të mbështetura gjatë gjithë procesit nga personel profesional i aftë për drejtimin, kontrollin dhe koordinimin teknik të punimeve.

Kërkesa që personeli kryesor drejtues teknik të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë lidhet me nevojën për të siguruar që specialistët e deklaruar për përmbushjen e kriterit përfaqësojnë kapacitetin teknik profesional të subjektit që do të realizojë kontratën.

Ndërkohë, kërkesa që personeli të figurojë në listëpagesën e shoqërisë për muajin Korrik 2026 synon të vërtetojë disponimin real dhe aktual të këtyre burimeve njerëzore nga operatori ekonomik në momentin e procedurës. Kjo kërkesë është e rëndësishme për të shmangur situatat ku një operator ekonomik deklaron specialistë të cilët nuk janë realisht pjesë e strukturës së tij profesionale dhe për të siguruar që kapaciteti i deklaruar është konkretisht i disponueshëm për realizimin e kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e diplomës, kontratës së punës, CV-së dhe librezës së punës për specialistët e deklaruar është përcaktuar me qëllim verifikimin e formimit profesional, marrëdhënies së punës dhe eksperiencës së tyre.

Këto dokumente mundësojnë verifikimin e profilit dhe nivelit të formimit profesional, marrëdhënies së punës me operatorin ekonomik, eksperiencës dhe përvojës profesionale dhe përputhshmërisë së profilit të specialistit me funksionin për të cilin kërkohet.

Në këtë mënyrë, Autoriteti/Enti Kontraktor siguron që personeli i deklaruar nuk është vetëm nominal, por disponon formimin dhe përvojën e nevojshme për të ushtruar funksionet teknike për të cilat kërkohet.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të pajisur me diplomë ose dëshmi përkatëse, të lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për muajin Korrik 2026, si më poshtë:

- *1 (një) teknik ndërtimi;*
- *1 (një) betonues;*
- *1 (një) hekurkthyes;*
- *1 (një) saldator;*
- *1 (një) automakinist (i cili mund të disponohet nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit);*
- *1 (një) shofer (i cili mund të disponohet nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit);*

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e

zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit” si dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", Urdhërin Nr. 109, datë 05.08.2013 ”Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, pasi për kryerjen e punimeve të veçanta sipas zërave të preventivit kërkohen specialistët e sipërpërmendur.

Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kriteri është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv, proceset konkrete të zbatimit dhe nevojën për të garantuar realizimin e tyre nga personel me kualifikimin dhe aftësitë profesionale përkatëse. Objekti i kontratës përfshin punime ndërtimore të kombinuara, ku ndërthuren punime për përgatitjen e terrenit, gërmime, punime betoni dhe betonarmeje, punime hekuri, si dhe punime me konstruksione metalike. Për realizimin e këtyre proceseve në mënyrë të organizuar dhe në përputhje me kërkesat teknike, është e nevojshme disponimi i një numri minimal punonjësish me profile specifike.

Kërkesa për një teknik ndërtimi lidhet me nevojën për të pasur në strukturën e operatorit ekonomik një punonjës me formim teknik në fushën e ndërtimit, i cili mund të angazhohet në zbatimin dhe organizimin e proceseve të punës në kantier. Në preventiv parashikohen një sërë punimesh ndërtimore, duke përfshirë punime gërmimi, punime dheu, punime betoni, betonarmeje dhe elemente të tjera të objektit. Tekniku i ndërtimit përbën një burim njerëzor të nevojshëm për mbështetjen e drejtimit teknik në organizimin e proceseve të punës, kontrollin e zbatimit të detajeve të projektit dhe koordinimin e punonjësve të specializuar në proceset e ndryshme të ndërtimit. Për rrjedhojë, kërkesa për këtë profil është në përputhje me natyrën e objektit dhe synon garantimin e një organizimi teknik të përshtatshëm të punimeve.

Preventivi përfshin punime betoni dhe betonarmeje, përfshirë përdorimin e betonit për realizimin e elementeve të objektit. Realizimi korrekt i këtyre punimeve kërkon personel të specializuar në përgatitjen, vendosjen, shpërndarjen, nivelimin dhe trajtimin e betonit, sipas kërkesave teknike të

projektit dhe specifikimeve përkatëse. Për këtë arsye, kërkesa për të paktën një betonues të kualifikuar lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që kanë në përmbajtje punime betoni dhe betonarmeje dhe synon të garantojë cilësinë e realizimit të këtyre proceseve.

Në preventiv parashikohen punime me hekur për strukturat, përfshirë përdorimin e shufrave të hekurit në elementet prej betonarmeje. Punimet e hekurit kërkojnë prerjen, përkuljen, përgatitjen dhe vendosjen e armaturës në përputhje me projektin konstruktiv dhe detajet teknike. Për këtë arsye, kërkesa për një hekurkthyes të kualifikuar është e lidhur drejtpërdrejt me proceset e punës të parashikuara në preventiv dhe synon që përgatitja dhe vendosja e armaturës të kryhet nga personel me aftësitë profesionale përkatëse.

Preventivi përfshin punime me konstruksione metalike, të cilat kërkojnë realizimin dhe bashkimin e elementeve metalike në përputhje me detajet dhe kërkesat e projektit. Proceset e saldimit kërkojnë aftësi dhe kualifikim specifik, pasi cilësia e bashkimeve të elementeve metalike ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e konstruksionit. Për këtë arsye, disponimi i një saldatori të kualifikuar është i justifikuar nga natyra e punimeve metalike të parashikuara dhe synon të sigurojë që këto procese të realizohen nga personel i specializuar.

Në preventiv parashikohen punime gërmimi me përdorimin e mjeteve mekanike, konkretisht gërmime me ekskavator, si dhe procese që lidhen me ngarkimin dhe transportin e materialeve.

Përdorimi i makinerive të rënda dhe mjeteve të punës në kantier kërkon operatorë të aftë dhe të kualifikuar, të cilët kanë njohuritë dhe autorizimet e nevojshme për drejtimin dhe operimin e mjeteve përkatëse. Për këtë arsye, kërkesa për një automakinist është e lidhur drejtpërdrejt me proceset mekanike të parashikuara në preventiv dhe synon të garantojë përdorimin e sigurt dhe teknikisht korrekt të makinerive gjatë realizimit të punimeve. Mundësia që ky punonjës të disponohet edhe nëpërmjet kontraktimit është parashikuar për t'i dhënë operatorit ekonomik fleksibilitet në mënyrën e sigurimit të këtij kapaciteti, duke garantuar njëkohësisht që personi i angazhuar të ketë kualifikimin e nevojshëm për funksionin përkatës.

Në preventiv parashikohen procese që lidhen me ngarkimin dhe transportin e materialeve të gërmuara dhe materialeve të tjera të nevojshme për realizimin e objektit. Për realizimin e këtyre proceseve është e nevojshme disponimi i personelit të aftë për drejtimin e mjeteve të transportit dhe për kryerjen e transportit të materialeve në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me kërkesat e zbatimit. Për këtë arsye, kërkesa për një shofer lidhet me nevojat logjistike dhe operative të zbatimit të kontratës. Edhe në këtë rast është parashikuar mundësia e kontraktimit të punonjësit, duke mos e kufizuar operatorin ekonomik vetëm në personelin e punësuar drejtpërdrejt, por duke i mundësuar sigurimin e këtij kapaciteti nëpërmjet një marrëdhënieje kontraktore të përshtatshme. Profilet profesionale të kërkuara në kriter janë të lidhura me proceset konkrete të zbatimit të objektit, si më poshtë:

Profili i kërkuar	Nevoja teknike që mbulon
Teknik ndërtimi	Organizimi dhe mbështetja teknike e proceseve të ndërtimit
Betonues	Realizimi i punimeve të betonit dhe betonarmesë
Hekurkthyes	Përgatitja, përpunimi dhe vendosja e armaturës
Saldator	Bashkimi dhe realizimi i elementeve/konstruksioneve metalike
Automakinist	Operimi i mjeteve dhe makinerive mekanike të përdorura në kantier
Shofer	Transporti i materialeve dhe mbështetja logjistike e kantierit

Kështu, kërkesat për personel nuk janë të shkëputura nga objekti i kontratës, por burojnë nga vetë proceset e punës të parashikuara në preventiv.

Kërkesa që punonjësit e specializuar të jenë të pajisur me diplomë ose dëshmi përkatëse, të lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, synon të sigurojë që kualifikimi profesional i personelit të jetë i dokumentuar dhe i verifikueshëm. Kjo kërkesë është e nevojshme për të garantuar që proceset e specializuara të punës nuk do të kryhen nga persona pa formimin profesional të përshtatshëm.

Në këtë mënyrë, Autoriteti siguron një nivel minimal të kapacitetit profesional të personelit që do të angazhohet drejtpërdrejt në proceset e zbatimit.

Kërkesa që punonjësit e kërkuar të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për muajin Korrik 2026 synon të verifikojë disponimin real dhe aktual të kapaciteteve njerëzore nga operatori ekonomik në periudhën përkatëse. Kjo kërkesë shërben për të garantuar se kapacitetet profesionale të deklaruara nuk janë vetëm formale, por janë realisht të disponueshme për operatorin ekonomik.

Për automakinistin dhe shoferin, kriteri lejon disponimin edhe nëpërmjet kontraktimit, duke marrë në konsideratë natyrën specifike dhe operative të këtyre funksioneve dhe duke i dhënë operatorit ekonomik mundësinë të sigurojë kapacitetet përkatëse edhe nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore. Kriteri synon të sigurojë që operatori ekonomik i kualifikuar të ketë kapacitetin njerëzor të nevojshëm për realizimin e punimeve sipas kërkesave të projektit, preventivit dhe dokumentacionit teknik të kontratës, duke garantuar njëkohësisht cilësinë, sigurinë dhe organizimin e duhur të procesit të zbatimit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore, për muajin Korrik 2026, prej minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) personash. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri do të vërtetohet me:

a) vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore;

b) listëpagesa e punonjësve, të konfirmuar nga autoritetet përkatëse, të shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me natyrën, volumet dhe organizimin e punimeve të parashikuara në specifikimet teknike.

Ky numër përfaqëson minimumin e nevojshëm për të garantuar që punimet të zhvillohen paralelisht, me cilësi dhe në përputhje me kërkesat për siguri, mjedis dhe afate. Një numër më i ulët do të detyronte operatorin të kryente proceset në mënyrë të fragmentuar, duke rritur rrezikun e vonesave, uljes së cilësisë dhe mosrespektimit të kushteve teknike të kontratës.

Numri minimal prej 15 (pesëmbëdhjetë) punonjësish është nxjerrë në funksion të proceseve konkrete të punës dhe të nevojës për organizimin e tyre në mënyrë të njëkohshme dhe të koordinuar, bazuar në zërat e preventivit të objektit “Rrethimi i varrezave Lekaj, Tërbaç”.

Përcaktimi i numrit 15 nuk është bërë thjesht si një numër i përgjithshëm i fuqisë punëtore, por është bazuar në ndarjen minimale të fuqisë punëtore sipas proceseve kryesore që duhet të realizohen gjatë zbatimit.

Në mënyrë konkrete, fuqia minimale prej 15 personash justifikohet si më poshtë:

Nr.	Procesi i punës	Fuqia minimale
1	Punime gërmimi me ekskavator dhe përgatitja e frontit të punës	2 persona
2	Ngarkim, transport dhe sistemim i materialeve të gërmuara	2 persona
3	Punime dheu, mbushje, rrafshim dhe sistemim	2 persona
4	Përgatitje, prerje, përkulje dhe vendosje e armaturës	3 persona
5	Punime betoni dhe betonarmeje	3 persona
6	Punime dhe montim konstruksionesh metalike, përfshirë saldimin	2 persona
7	Punë ndihmëse dhe organizim i përgjithshëm i kantierit	1 person
	TOTAL	15 persona

Kjo ndarje lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit, i cili parashikon punime gërmimi me mjete mekanike, ngarkim dhe transport të materialeve, punime dheu, punime hekuri, punime betoni/betonarmeje dhe konstruksione metalike.

1. Dy persona për punimet e gërmimit

Preventivi parashikon gërmime me ekskavator në kanale, përfshirë ngarkimin dhe transportin e materialit. Për këtë proces parashikohet një minimum prej 2 personash, ku përfshihet operatori i mjetit mekanik dhe një punonjës mbështetës për orientimin e punimeve, kontrollin e frontit të gërmimit dhe punët manuale shoqëruese.

2. Dy persona për ngarkimin, transportin dhe sistemimin

Procesi i gërmimit shoqërohet me largimin/transportin e materialit dhe sistemimin e tij. Për këtë arsye parashikohen 2 persona, të nevojshëm për realizimin dhe mbështetjen e procesit të transportit dhe të logjistikës së materialeve.

3. Dy persona për punimet e dheut

Punimet e dheut, përfshirë mbushjen, hedhjen, rrafshimin dhe sistemimin, kërkojnë punë manuale dhe mbështetje të vazhdueshme në kantier. Për këtë proces parashikohen minimalisht 2 persona, me qëllim që punimet e dheut të mund të zhvillohen në mënyrë të pavarur nga proceset e tjera.

4. Tre persona për punimet e hekurit

Preventivi përfshin punime hekuri dhe armature. Për përgatitjen e armaturës kërkohet një grup minimal prej 3 personash, për të realizuar prerjen, përkuljen, lidhjen dhe vendosjen e hekurit sipas kërkesave të projektit. Ky numër mundëson që procesi i përgatitjes dhe vendosjes së armaturës të zhvillohet pa ndërprerje dhe në koordinim me procesin pasues të betonimit.

5. Tre persona për punimet e betonit dhe betonarmesë

Preventivi përfshin punime betoni dhe betonarmeje. Për realizimin e këtij procesi kërkohet një grup minimal prej 3 personash, duke përfshirë personelin e specializuar dhe punonjësit ndihmës të nevojshëm për përgatitjen e frontit të betonimit, vendosjen dhe shpërndarjen e betonit, nivelimin dhe përfundimin e procesit.

6. Dy persona për konstruksionet metalike

Preventivi parashikon punime me konstruksione metalike. Për realizimin e këtij procesi kërkohen minimalisht 2 persona, ku përfshihet personeli i specializuar për bashkimin/montimin e elementeve metalike dhe punonjësi ndihmës për pozicionimin, mbajtjen dhe montimin e elementeve.

7. Një person për punët ndihmëse dhe organizimin e kantierit

Përveç grupeve të mësipërme, nevojitet minimalisht 1 punonjës shtesë për punë ndihmëse, sistemimin e materialeve, përgatitjen e frontit të punës, pastrimin dhe mbështetjen e proceseve të ndryshme të kantierit. Numri 15 përfaqëson fuqinë minimale që lejon mbulimin e proceseve kryesore të identifikuar në preventiv pa qenë e nevojshme që i njëjti punonjës të angazhohet njëkohësisht në procese të ndryshme. Një numër më i ulët do të sillte nevojën për të zhvendosur të njëjtët punonjës nga një proces në tjetrin dhe do të krijonte varësi ndërmjet proceseve të gërmimit, punimeve të dheut, hekurit, betonit dhe konstruksioneve metalike. Kjo do të ndikonte në organizimin e frontit të punës dhe në mundësinë e zhvillimit paralel të proceseve.

Në të kundërt, numri prej 15 personash përbën një nivel minimal të fuqisë punëtore që mundëson organizimin e grupeve të punës sipas proceseve kryesore të preventivit.

Në këtë mënyrë, numri minimal prej 15 punonjësish është i lidhur drejtpërdrejt me strukturën e proceseve të punës të parashikuara në preventiv dhe synon të sigurojë kapacitetin minimal njerëzor të nevojshëm për realizimin e tyre në mënyrë të koordinuar dhe brenda afateve të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Emri i mjetit</i>	<i>Njesi</i>	<i>Sasi</i>	<i>Statusi</i>
1	<i>Eskavator me goma</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
2	<i>Kamion me kapacitet 10 - 20 ton</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
3	<i>Kamioncine me kapacitet 1-2 ton</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
4	<i>Kamion me vinc me kapacitet deri 3 ton</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
5	<i>Saldatrice elektrike/ Elektrosaldatrice</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
6	<i>Tranxh per kthim hekuri</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
7	<i>Tranxh për prerje hekuri</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
8	<i>Gjenerator</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
9	<i>Betoforma (armaturë, kallëp) dërrase</i>	<i>m²</i>	<i>150</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
10	<i>Betonierë kantieri 0.5m³ (stacionere)</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>

11	Autopompëbetoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Autobetonierë	copë	2	Në pronësi ose me qera
13	Vibrator betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 15 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 1 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 4 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Për mjetet në pronësi duhet të paraqiten:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit;
- b) leja e qarkullimit;
- c) certifikata e kontrollit teknik;
- ç) siguracioni i mjetit, i vlefshëm.

Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqiten:

